



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2020:907627

Datë: 25.07.2023

Numri i dokumentit: 04521287

Rev.nr.291/23

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Nenad Lazic, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit: N. B. nga Komuna e F., të cilën e përfaqëson Lavdrim Xheladini, avokat në F., sipas autorizimit, kundër të paditurit M. B. nga F., për vërtetimin e pronësisë, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr 1837/18, të datës 28.09.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 24.07.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË i palejuar revizioni i të paditurit: M. B. nga F., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr 1837/18, të datës 28.09.2022.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithëshem, C.nr.136/1, i datës 11.12.2017, është vendosur: në pikën I (një) të dispozitivit është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N. B. nga F. dhe është detyruar i padituri M. B. nga F. që sipërfaqet prej 34.8 m² dhe 8.3 m², të cilat janë pjesë e ngastrës kadastrale ..., Zona Kadastrale në F., ti liroj nga objektet dhe sendet dhe ashtu të lira t'ia dorëzoj paditësit N. B. nga F.. Sipërfaqja e sipër përmendur prej 34.8 m² katërorë ka këto kufi dhe përmasa në anën veriore nga pika 11 deri te pika 10 në gjatësi prej 6.96 metra kufizohet me ngastrën numër ZK F., kurse nga pika 10 deri në pikën 4 në gjatësi prej 8.95 metra kufizohet me ngastrën kadastrale ., në anën lindore nga pika 4 deri te pika 22, në gjatësi prej 2.41 metra kufizohet në rrugën publike “.”. Në anën jugore nga pika 22 deri te pika 23 në gjatësi prej 15.94 metra kufizohet me ngastrën, në anën perëndimore në gjatësi prej 2.12 metra kufizohet me ngastrën kadastrale Sipërfaqja e sipër përmendur prej

8.3 m² ka këto kufi dhe përmasa: në anën veriore kufizohet nga pika 21 deri te pika 11 në gjatësi prej 3.64 metra kufizohet me ngastrën kadastrale Në anën lindore nga pika 11 deri në pikën 23 në gjatësi prej 2.12 metra kufizohet me ngastrën, në anën jugore nga pika 23 deri te pika numër 402 në gjatësi 3.44 metra kufizohet me ngastrën numër dhe anën perëndimore nga pika numër 402 deri te pika numër 21 në gjatësi 2.64 metra kufizohet me ngastrën ..., të gjitha ngastrat kadastrale gjinden në Zonën Kadastrale në F.. Në pikën II (dy) të dispozitivit ka detyruar të paditurin M. B. që paditësit N.B. në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguaj shumën prej 841 euro. Në pikën III (tre) të dispozitivit ka detyruar paditësin që kësaj gjykate në emër të shtesës gjyqësore për padi t'ia paguaj shumën e të hollave prej 50 euro.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr 1837/18, të datës 28.09.2022, është vendosur:: Refuzohet e pathemeltë ankesa e të paditurit M. B. nga F., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.136/1, i datës 11.12.2017, vërtetohet.

Kundër këtij aktgjykimi i padituri në afat ligjorë, ka paraqit revizion për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni si i bazuar, të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.136/1, i datës 11.12.2017 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr 1837/18, të datës 28.09.2022, ndërsa lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në shkallës e parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 218, 221 dhe 230, konstatoi se:

Revizioni i të paditurit është i palejueshëm.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi më datë 23.02.2011, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për lirimin e patundshmërisë kundër të paditurit, me të cilën ka kërkuar që të miratohet padia e paditësit dhe të detyrohet i padituri që pjesën e uzurpuar ta liroj nga sendet dhe objektet, si dhe ti paguajë shpenzimet procedurale, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe shqyrtimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.136/11, i datës 31.01.2018, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, i padituri ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj, Ac.nr 1837/18, të datës 28.09.2022, ka vendosur që të refuzojë ankesën e të paditurit, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetojë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i padituri ka paraqitur revizion, andaj Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë çështje juridike kontestimore fillimisht bënë vlerësimin e lejueshmërisë së revizionit dhe konstatoi se në këtë rast revizioni është i palejueshëm, për arsye se:

Me neni 218, të LPK-së, dhe nenin 11, të Ligjit Nr. 04/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, me të cilin është riformuluar neni 218 i ligjit bazik, përcaktohet se: “ 1. Revizioni i paraqitur pas kohe, i palejueshëm apo jo i plotë, hudhet poshtë me aktvendim të gjykatës së shkallës së parë pa mbajtur seancë gjyqësore. 2. Revizioni është i palejueshëm nëse: a) e ka paraqitur personi i cili nuk është i autorizuar për paraqitjen e revizionit; b) revizionin e ka paraqitur personi i cili e ka tërhequr revizionin; c) nëse personi i cili ka paraqitur revizionin nuk ka interes për paraqitjen e tij; d) është paraqitur revizioni kundër aktgjykimit kundër të cilit sipas ligjit nuk mund të paraqitet ”.

Me nenin 211 paragraf 3, të LPK, përcaktohet se: “ Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore - juridike në të cilat kërkesëpadia nuk ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë paditësit nuk e kalon shumën prej 3.000 € ”, ndërsa në paragrafin 4, të këtij neni përcaktohen përjashtimet, si: “ Përjashtimisht edhe kur bëhet fjalë për kërkesëpadinë nga par.2 dhe 3 të këtij neni, revizioni gjithmonë është i lejuar: a) në kontestet për ushqim , b) në kontestet për shpërblimin e dëmit për ushqimin e humbur për shkak të vdekjes së dhënies së ushqimit dhe c) ndaj kontestet ndaj marrëdhëniet e punës të cilat i fillon i punësuar kundër vendimit për shuarjen e marrëdhënies së punës ”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata Supreme e Kosovës erdhi në përfundim se revizioni nuk lejohet kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr 1837/18, të datës 28.09.2022, për arsye se dispozitat e cituara i referohen lejueshmërisë së revizionit e kushtëzuar me vlerën e kontestit e cila duhet të jetë mbi 3,000 €, për të qenë i lejuar revizioni, dhe situatës kur revizioni lejohet pavarësisht vlerës së kontestit sipas kriterit përjashtues për natyrën e çështjes kontestuese.

Në këtë rast vlera e kontestit e përcaktuar - treguar në padi nga pala paditëse është 800 €, e cila nuk e kalon shumën prej 3,000 €, dhe po ashtu natyra e kontestit nuk përbën përjashtim për lejueshmërinë e revizionit (përjashtimet pavarësisht vlerës), prandaj në këtë rast për shkak të vlerës së kontestit, revizioni është i palejuar.

Andaj me qenë se gjykata e shkallë së parë nuk e ka hedh revizionin e të paditurit ashtu siç përcaktohet me nenin 218 të LK-së, atëherë Gjykata Supreme e Kosovës në kuptim të nenit 221 të LPK-së, vendosi që ta hedhë poshtë si të palejueshëm revizionin.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me nenin 221 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr. 291/23, më datë 24.07.2023

Kryetari i kolegjit
Rrustem Thaqi